REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 6560/2 Prot. Divjakë më 11.08.2026

PROJEKT-VENDIM
Nr 72, datë 11.08.2026

PËR
" PËR SHPREHJEN E MENDIMIT TË KËSHILLTARËVE MBI PROPOZIMIN PËR REFORMËN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE 2.0"

Mbështetur në shkresën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me nr 3573 datë 31.07.2026, ardhur në Bashki m dhe protok.me nr.6445 datë 03.08.2026,si dhe në:

- nenin 108, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit kufijtë e njësive të vetëqeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to;
- nenet 86–90 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", veçanërisht kërkesat për argumentimin e riorganizimit, paraqitjen e mendimit të popullsisë së njësive që riorganizohen dhe marrjen e mendimit zyrtar të këshillave bashkiakë të përfshirë drejtpërdrejt;
- të drejtën dhe përgjegjësinë e Këshillit Bashkiak Divjakë për të përfaqësuar interesat e komunitetit vendor dhe për t'u shprehur institucionalisht mbi çdo ndryshim që prek statusin, territorin, përfaqësimin, financat, pasuritë dhe vazhdimësinë e shërbimeve vendore;

PROPOZOJ:

1. Këshilltarët e Këshillit Bashkiak Divjakë të shqyrtojnë draft-propozimin për shkrirjen e Bashkisë Divjakë dhe bashkimin e saj me Bashkinë Lushnje si dhe ttë shprehin mendimin e tyre me një akt zyrtar.
2. Të shprehë Vendimin e Këshillit Bashkiak Divjakë me propozimin për bashkimin e Bashkisë Divjakë me Bashkinë Lushnje dhe me humbjen e statusit të Bashkisë Divjakë si njësi më vete e vetëqeverisjes vendore.
3. Të kërkojë që në dosjen parlamentare dhe në raportin përfundimtar të procesit të pasqyrohet i plotë ky vendim, së bashku me çdo mendim kundër të anëtarëve të këshillit dhe me dokumentacionin e konsultimit të komunitetit vendor.
4. Kryetari i Këshillit Bashkiak autorizohet t'ia përcjellë këtë vendim Kuvendit të Shqipërisë, komisionit parlamentar përgjegjës, propozuesve të projektligjit, Këshillit të Ministrave, Prefektit të Qarkut Fier dhe institucioneve të tjera të interesuara.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Liri Biti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIVJAKË